



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



07/03/2024
02/149



Prishtinë, 2024

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4, të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, si dhe Ligjin Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, si dhe duke u bazuar në Raportin vlerësues për Grantin e Performancës Komunale për vitin 2022, periudha e alokimit 2024, të aprovuar nga Komisioni i Grantit për Performancë Komunale me dt. 09.02.2024 arrihet kjo:

MARRËVESHJE PËR NDARJEN E GRANTIT PËR PERFORMANCË KOMUNALE PËR VITIN 2024

Ndërmjet:

1. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësuar nga z. Elbert Krasniqi, Minister i MAPL-së (në tekstin e mëtejme MAPL),
2. Helvetas Swiss Intercooperation, përfaqësuar nga z. Ertan Munoglu, Menaxheri i Projektit DEMOS (në tekstin e mëtejme DEMOS) dhe,
3. Komunës së Shtimes, përfaqësuar nga z. Qemajl Aliu, Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna).

Neni 1 Qëllimi

MAPL dhe HELVETAS pajtohen për ndarjen e mjeteve nga skema e grantit për performancë komunale për vitin 2024.

Neni 2 Financimi

1. Vlera e ndarë e grantit për vitin 2024 për komunën e Shtimes është 396,950.13 Euro.
2. Shuma nga pika 1, e këtij neni financohet nga fondet e MAPL-së dhe HELVETAS, proporcionalisht me kontributin e tyre në GPK.

3. Pagesat lidhur me fondet e MAPL-së, bëhen nga MAPL, tek operatorët ekonomik, bazuar në realizimin e punimeve sipas kontratës për implementim të projekteve.
4. Mjetet e HELVETAS, transferohen në buxhetin e komunës përmes Thesarit/MFPT-ës, pas nënshkrimit të marrëveshjeve individuale.

Neni 3 Shfrytëzimi i grantit

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje, do të nënshkruajnë marrëveshje të veçantë tre palëshe për financim të projekteve në komunë, përmes së cilës do të përcaktohen obligimet, detyrat dhe përgjegjësitë për secilën palë.

Inkurajohet komuna të hartojë projektet ideore që do të financohen nga ky grant që prekin fushat, si: Agjendën e gjelbër, përfshirë eficienten e energjisë; Gjithpërfshirjen (barazinë gjinore, komunitetet jo shumicë dhe personat me aftësi të kufizuara); dhe Dixhitalizimin e shërbimeve komunale.

Neni 4 Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga MAPL, DEMOS dhe Komuna.
2. Kjo marrëveshje është nënshkruar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze në tri (3) kopje autentike, një për secilën nga palët nënshkruese.

Palët Nënshkruese

Elbert Krasniqi
Ministër i MAPL-ës



Ertan Munoglu
Menaxher i projektit DEMOS



Qemajl Aliu
Kryetar, Komuna Shtime


